EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5723
E martë, 12 mars 2019
çmimi 0.40 €

Hoxha: Vendimi për vizat, pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BARDHYL MAHMUTI FAQE 4-5

DEMONSTRATAT E VITIT 1981 KISHIN NË THELB IDEOLOGJINË KOMBËTARE

Me rastin e 38-vjetorit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka folur një nga demonstruesit e planit të parë, siç dokumentohet edhe me fotografi, të cilat, pas arrestimit të tij, u përdorën si dëshmi gjyqësore. Në këtë intervistë përfaqësuesi i mëvonshëm politik i UÇK-së, politologu Bardhyl Mahmuti, flet rreth karakterit ideologjik të këtyre demonstratave, kërkesave dhe ndikimit të tyre për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe, përgjithësisht, çështjes sonë kombëtare. Bardhyl Mahmuti ka thënë se demonstratat e vitit 1981 shënuan pikën kulmore të konfliktit pa kthim pas

KËSHILLTARËT E MERKELIT SJELLIN POROSINË E KANCELARES PËR DIALOGUN ME SERBINË

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, dhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj kanë takuar të hënën ndaras këshilltarët e kancelares gjermane Angela Merkel, Jan Hecker dhe Matthias Luttenberg, me të cilët kanë biseduar për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Zyrtarët e lartë gjermanë nuk kanë folur për vizitën e tyre në Prishtinë, derisa Haradinaj e Hoxhaj kanë treguar se kanë diskutuar për zhvillimet aktuale në vend, për procesin e dialogut me Serbinë, për konsolidimin

e brendshëm të Kosovës dhe për rrugën e saj euroatlantike. As Haradinaj dhe as Hoxhaj nuk e kanë përmendur se në këto takime është diskutuar për taksën ndaj mallrave serbe

Promovohet libri 'Fitorja diplomatike' i autorit Sabri Kiçmari

FAQE 6

AKTUALE

JANË 100 ARSYE PSE KA QENË E ARSYESHME TAKSA 100 PËR QIND PËR MALLRAT NGA SERBIA DHE BOSNJA F. 10

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

NISIN PUNIMET PËR NDËRTIMIN E PARKUT TË RI NË LAGJEN 'ARBËRIA' F. 10

PRESIDENTI THAÇI PRANOI LETRAT KREDENCIALE NGA AMBASADORI I KATARIT F. 7

EKONOMI

KOSOVA, ADRESË E BESUESHME PËR INVESTIME AMERIKANE F. 8

BIZNESET ANKOHEN PËR MONOPOLIZIM TË TREGUT TË ENERGJISË F. 8

SPORT

BEQIRI: NUK DUAM HUMBJE NË DRENAS F. 13

SYLEJMAN SELIMI VIZITON FFK-në F. 13

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Limaj: Në Bruksel e dorëzuam Platformën për dialogun

Prishtinë, 11 mars - Dy bashkëkryesuesit e delegacionit për dialogun me Serbinë, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, kanë udhëtuar të dielën për në Bruksel, me qëllim që ta dorëzojnë Platformën e dialogut e cila javën që shkoi u votua në Kuvendin e Kosovës.

Bashkëkryesuesi i delegacionit shtetëror për dialogun, Fatmir Limaj, në një deklaratë për "KosovaPress", tha se qëllimi i shkuarjes në Bruksel ka qenë që zyrës së shefes së diplomacisë së Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, t'ia dorëzojnë edhe formalisht Platformën për dialogun. "Ashtu siç edhe kemi paralajmëruar, platformën e dialogut e kemi dorëzuar edhe formalisht te zyra e shefes së BE-së, Federica Mogherini. Njëkohësisht qëllimi i takimit me përfaqësues të kësaj zyre është njoftimi me votën e deputetëve për dialogun e, po ashtu, i kemi njoftuar se Kosova tashmë ka qëndrim zyrtar për dialogun", ka thënë Limaj. Ai ka treguar se i kanë njoftuar përfaqësuesit evropianë edhe për kalimin në Parlament të Ligjit për Dialogun si dhe angazhimin e institucioneve të Kosovës për të çuar përpara këtë proces të rëndësishëm për vendin.

Duke komentuar shkrimet se bashkëkryesuesit kanë shkuar tinëz në Bruksel, Limaj ka thënë se ky është takim i rregullt i delegacionit dhe se nuk ka asgjë për të mbajtur fshehtë, pasi që e kanë paralajmëruar se pas votimit platformën dhe qëndrimin zyrtar të Kosovës do ta dërgojnë në Bruksel. Platforma për dialogun dhe ligji për dialogun kanë marrë votat e deputetëve të Kuvendit të Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme të mbajtur më 7 mars.

Ambasada e ShBA-së kërkon përgjegjësi në rastin e dëbimit të turqve nga Kosova

Ambasada e ShBA-së në Kosovë, përmes një deklarate për medie, duke shprehur pakënaqësinë rreth dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova, ka thënë se gjetjet e komisionit hetimor parlamentar, që janë 31 shkelje nga institucionet e Kosovës lidhur me këtë rast, ngrenë shqetësime rreth mashtrimit nga agjencitë kryesore të sigurisë si dhe ndjeshmërinë e sektorit të sigurisë ndaj manipulimit politik

Prishtinë, 11 mars - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë ka reaguar lidhur me procesin e zbardhjes së rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova nën dyshimin se ata paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës.

Nëpërmjet një deklarate për medie, Ambasada Amerikane u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës të sigurojnë përgjegjësi të plotë për këdo që shkel ligjin si dhe u ka rikujtuar liderëve të Kosovës që institucionet e sigurisë duhet të veprojnë vetëm brenda autoritetit kushtetues në varësi të sundimit të ligjit. "Nuk kemi të bëjmë me fajësinë apo pafajësinë e individëve, por shmangie të qartë të proceseve ligjore të Kosovës nga ana e politikanëve të Kosovës. Presioni politik në sektorin e sigurisë për ta shkelur ligjin e Kosovës është një shkelje skandaloze e vlerave demokratike. Ne nxisim transparencën e plotë në sektorin e sigurisë dhe në drejtimin e punëve të jashtme për t'i parandaluar ndërhyrjet e pavenda nga politikanët kosovarë në të ardhmen", është thënë në deklaratën e Ambasadës së ShBA-ve në Kosovë.

Në këtë deklaratë thuhet se kaloi rreth një vit që kur Kosova pa një proces të rregullt dëboi gjashtë shtetas turq nga Kosova, nën dyshimin se ata paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës. "Ne ishim të kënaqur ta shihnim themelimin e një komisioni hetimor parlamentar i cili zbuloi shkelje ligjore lidhur me incidentin, pavarësisht prej përpjekjeve për ta penguar punën e tij. Gjetjet e komisionit, të cilat sugjerojnë në 31 shkelje ligjore ose procedurale nga ana e Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe institucioneve të tjera, ngrenë shqetësime rreth mashtrimit nga ana e agjencive kryesore të sigurisë si dhe ndjeshmërinë e sektorit të sigurisë ndaj manipulimit politik", thuhet në deklaratën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Ambasada u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës të sigurojnë përgjegjësi të plotë për këdo që shkel ligjin dhe ua rikujton liderëve të Kosovës që institucionet e sigurisë duhet të veprojnë vetëm brenda autoritetit kushtetues, në varësi të sundimit të ligjit. "Nuk kemi të bëjmë me fajësinë apo pafajësinë e individëve, por shmangie të qartë të proceseve ligjore të Kosovës nga ana e politikanëve të Kosovës. Presioni politik në sektorin e sigurisë, për ta shkelur ligjin e Kosovës, është një shkelje skandaloze e vlerave demokratike. Ne nxisim transparencën e plotë në sektorin e sigurisë dhe në drejtimin e punëve të jashtme, për t'i parandaluar ndërhyrjet e pavenda nga politikanët kosovarë në të ardhmen", thuhet në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë.

Rudina Hajdari nuk pranon ta djegë mandatin

Tiranë, 11 mars - Deputetja e Partisë Demokratike (PD), Rudina Hajdari, u ka dhënë fund dilemave lidhur me mandatin e saj. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Hajdari ka deklaruar se "Parlamenti është vendi ku ajo do të vazhdojë t'i shërbejë elektoratit". Deklarata e Hajdarit bie në kundërshtim me qëndrimin politik të marrë nga Partia Demokratike dhe gjithë opozita për djegien e mandateve në bllok.

Hajdari në këtë mënyrë bashkohet me Lefter Maliqin, Ylli Shehun etj., të cilët kanë pranuar t'i marrin mandatet e lëna nga opozita në shenjë reagimi ndaj qeverisë. "Parlamenti i jep oksigjen demokracisë në vend, u jep oksigjen partive politike. Është vendi ku ne përfaqësojmë sovranin, prandaj duke marrë parasysh që kjo është një përgjegjshmëri e lartë që ndiej mbi shpatulla, mendoj se qëndrimi në parlament është vendimi i duhur që i shërben të ardhmes së Shqipërisë", tha Hajdari.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Këshilltarët politikë të kancelares së Gjermanisë Angela Merkel, Jan Hecker dhe Matthias Luttenberg, kanë qëndruar për vizitë në Kosovë

Këshilltarët e Merkelit sjellin porosinë e kancelares për dialogun me Serbinë

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, dhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj kanë takuar të hënën ndaras këshilltarët e kancelares gjermane Angela Merkel, Jan Hecker dhe Matthias Luttenberg, me të cilët kanë biseduar për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Zyrtarët e lartë gjermanë nuk kanë folur për vizitën e tyre në Prishtinë, derisa Haradinaj dhe Hoxhaj kanë treguar se kanë diskutuar për zhvillimet aktuale në vend, për procesin e dialogut me Serbinë, konsolidimin e brendshëm të Kosovës dhe rrugën e saj euroatlantike. As Haradinaj dhe as Hoxhaj nuk e kanë përmendur se në këto takime është diskutuar për taksën ndaj mallrave serbe

EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtinë, 11 mars - Këshilltarët e kancelares gjermane Angela Merkel, Jan Hecker dhe Matthias Luttenberg, kanë takuar të hënën në Prishtinë kryeministrin Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj. Të parët nuk kanë dhënë ndonjë deklaratë për takimet, kurse të dytët kanë vlerësuar se mbështetja e Gjermanisë në procesin e dialogut me Serbinë është shumë e rëndësishme. As Haradinaj dhe as Hoxhaj, në postimet e tyre në "Facebook", nuk e kanë përmendur çështjen e taksës ndaj mallrave serbe. Në profilin e vet në "Facebook", kryeministri Ramush Haradinaj ka shkruar se është mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme të Gjermanisë në të gjitha etapat e shtetndërtimit të Kosovës. Sipas tij, shteti gjerman është partner i rëndësishëm ekonomik dhe politik i Kosovës. "Bisedë e hapur me këshilltarët politikë të kancelares gjermane Angela Merkel, Jan Hecker dhe Matthias Luttenberg, për zhvillimet aktuale në vend, për procesin e dialogut me Serbinë, për konsolidimin e brendshëm të Kosovës dhe rrugën e saj euroatlantike. Mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme të Gjermanisë në të gjitha etapat e shtetndërtimit të Kosovës. Shteti gjerman është partner i rëndësishëm ekonomik dhe politik i Kosovës dhe zë i fuqishëm i saj në strukturat euroatlantike", ka shkruar Haradinaj.

Ndërsa zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, i cili zyrtarët e larët gjermanë i ka pritur pas kryeministrit, ka shkruar se viti 2019 paraqet momentumin më të favorshëm për arritjen e marrëveshjes me Serbinë. "Diskutim i frytshëm me këshilltarin kryesor të kancelares gjermane Merkel për politikë të jashtme, Jan Hecker. E informova për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe për hapat që kemi ndërmarrë në funksion të vazhdimit të dialogut me Serbinë", ka shkruar Hoxhaj, duke shtuar se mbështetja e Gjermanisë në procesin e dialogut është jashtëzakonisht e rëndësishme. "Roli dhe mbështetja e Gjermanisë dhe e aleatëve të tjerë të Kosovës në procesin e dialogut është jashtëzakonisht e rëndësishme. Viti 2019 paraqet momentum shumë të favorshëm për arritjen e një marrëveshjeje historike, e cila duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë dhe anëtarësim të Kosovës në OKB", ka shkruar Hoxhaj.

Koordinatori Hoti vizitoi komunën e Tutinit në Sanxhak

Sanxhak, 11 mars (ER) - Kenan Hot, kryetar i Komunës së Tutinit në Sanxhak të Serbisë, ka pritur në takim zyrtar delegacionin nga Kosova të udhëhequr nga koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti.

Koordinatori Hoti ka thënë se këtë vizitë është duke e zhvilluar me qëllim të bashkëpunimit me nxënësit dhe studentët e këtyre trevave. "Bashkëpunimi për të mirën e të rinjve është tejet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Kur është fjala për nxënësit ne duhet t'i përafrojmë qëndrimet duke lënë anash dallimet partiake apo etnike. Prandaj, Programi Nacional për Rininë është i përkthyer edhe në gjuhën boshnjake dhe është një program që për nxënësit realizohet në formë gare në fushën e diturisë, sportit dhe kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik. Ky program nuk e përjashton askënd, prandaj unë dua që edhe ju të jeni pjesë e tij", ka thënë Hoti.

I gatshëm për bashkëpunim dhe përkrahje të Programit për Rininë është shprehur edhe kryetari i Tutinit, Kenan Hot. "Është një vizitë shumë e veçantë për komunën tonë. Edhe më i veçantë është ky program që sot na keni sjellë. Ne duhet t'u ofrojmë të rinjve tanë mundësinë që të njihen mes vete në forma të ndryshme, qoftë nëpërmjet sportit apo kreativitetit. Unë jam i gatshëm ta fillojmë etapën e bashkëpunimit me Kosovën", ka thënë Hot.

Në shenjë simbolike, Hoti ia ka dhuruar kryetarit të Tutinit figurën e Hyjneshës në Fron. Pjesë e delegacionit nga Kosova ishte edhe kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, profesori Nexhmedin Spahiu, udhëheqësi i Shoqatës "Kosova për Sanxhakun", Ismet Azizi dhe Xhelal Shaqiri, zyrtar ndërlidhës i Zyrës së Kosovës në Beograd.

Flet për "Epokën e re", Bardhyl Mahmuti

Demonstratat e vitit 1981 kishin

Me rastin e 38-vjetorit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka folur një nga demonstruesit e planit të parë, siç dokumentohet edhe me fotografi, të cilat, pas arrestimit të tij, u përdorën si dëshmi gjyqësore. Në këtë intervistë përfaqësuesi i mëvonshëm politik i UÇK-së, politologu Bardhyl Mahmuti, flet rreth karakterit ideologjik të këtyre demonstratave, kërkesave dhe ndikimit të tyre për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe, përgjithësisht, çështjes sonë kombëtare. Bardhyl Mahmuti ka thënë se demonstratat e vitit 1981 shënuan pikën kulmore të konfliktit pa kthim pas

Lulëzim ETEMAJ

PRISHTINË, 11 MARS - Duke qenë se ndodhemi në ditën e 38-vjetorit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, rreth karakterit ideologjik të tyre, kërkesave dhe ndikimit të tyre për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe përgjithësisht çështjes sonë kombëtare, për gazetën "Epoka e re" biseduam me njërin nga demonstruesit e planit të parë, siç dokumentohet edhe me fotografi, të cilat, pas arrestimit të tij, u përdorën edhe si dëshmi gjyqësore. Biseduam me përfaqësuesin e mëvonshëm politik të UÇK-së, politologun Bardhyl Mahmuti.

"Epoka e re": *Në një foto të demonstratave të vitit 1981 ju shiheni në ballë të protestuesve. Meqenëse u dënuat individualisht e jo në kuadër të ndonjë organizate, na intereson të dimë nëse pjesëmarrja juaj ishte si individ apo si anëtar i ndonjë organizate.*

Mahmuti: Që të kuptohen drejt këto ngjarje, mendoj se duhet t'i shohim në kontekstin shoqëror dhe historik kur ndodhën. Po veçoj vetëm një aspekt të çështjes. Ishte periudha e vitit 1978, periudhë që karakterizohej me manifestimin në qindra forma të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ky kontekst kishte krijuar një atmosferë tejet të favorshme për veprimtari në interes të mobilizimeve për realizimin e aspiratave, që kishin mbetur pa u realizuar që nga koha e Lidhjes së Prizrenit. Në këto rrethana u angazhova në radhët e organizatës Kushtrimi i Lirisë që, në një farë forme, ishte Degë e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës. Krahas edukimit në familje, në kuadër të së cilës, përveç babait tim, kishte disa të dënuar për aktivitete politike kundër pushtetit jugosllav dhe ndikimit që kishte mësuesja ime Emine Vela-Isaku, e cila i kishte burrin dhe të vëllanë të burgosur për arsye të njëjtë, angazhimi në kuadër të Kushtrimit të Lirisë ndikoi që në ditën e shpërthimit të atyre protestave të shihja veten, në mënyrë të natyrshme, pjesëmarrës të asaj revolte kundër pushtuesve të territoreve tona.

"Epoka e re": *Çfarë mund të na thoni lidhur me atë foto? A dini detaje si është bërë?*

Mahmuti: Pasi jam arrestuar, hetuesia në Prishtinë m'i tregoi një numër fotosh, ku shihesha në demonstratat e datave të ndryshme dhe në disa vende të qytetit. Ato ishin si "provë materiale" që dëshmonte "për armiqësinë time kundër pushtetit të klasës punëtore dhe të socializmit vetëqeverisës të Jugosllavisë" dhe "cenimin e rendit kushtetues të Jugosllavisë". Lidhur me realizimin praktik të atyre fotove mund vetëm të supozojmë se janë bërë nga shërbimet sekrete të shtetit. Ajo që mund të them në këtë intervistë ka të bëjë me faktin se aktakuzës kundër meje gjykatësi hetues i ka bashkangjitur 23 foto për ta dëshmuar veprimtarinë time.

"Epoka e re": *Cili ishte karakteri i atyre demonstratave, sepse jo rrallë u jepet karakter ideologjik, i orientimit të majtë?*

Mahmuti: Në një intervistë për një studente, që është duke e bërë temën e masterit për format e komunikimit të organizatave të fshehta, më është bërë e njëjta pyetje. Këto çështje duhet të sqarohen, për arsye se rreth kësaj problematike është manipuluar më së shumti. Fatkeqësisht, manipulimi është bërë nga njerëzit e ish-strukturave të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë të cilët u kanë shërbyer politikave antishqiptare për përfitime personale. Që të kuptohet drejt kjo çështje, duhet të sqarohen dy terme "komunizmi" dhe "nacionalizmi". Në kuadër të një interviste nuk mund të zgjerohem shumë rreth këtyre nocioneve, prandaj do të mundohem që sa më shkurtimisht ta nxjerr në shesh thelbin e problemit. Në aspektin e orientimit ideologjik, komunizmi ka për bazë luftën e klasave: luftën e klasës punëtore kundër klasës së borgjezisë. Lufta është e pakompromis në nivelin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, prandaj kërkohet internacionalizmi proletar dhe lufta e vazhdueshme kundër borgjezisë së kombit të vet. Nga ana tjetër, ideologjia kombëtare ka për orientim homogjenizimin brenda kombit të caktuar dhe dallimi (apo lufta) me kombet e tjerë.

Në raport me shqiptarët, që jetonin në viset e tyre jashtë vendit amë, Shqipëria e viteve '70 ishte mobilizuar në të gjitha aspektet për ta ngritur vetëdijen e tyre kombëtare dhe në këtë kontekst ideologjia kombëtare, në kuptimin e ideologjisë shtetformuese, është dominuese. Po përmend vetëm një shembull. Nga të gjitha veprat shkencore dhe të krijimtarisë artistike të asaj dekade, kënga "Xhamadani i trimërisë" u shndërrua në emblemë që këndohej si të ishte himn kombëtar. Po rikujtoj se fjalia kryesore e kësaj kënge theksonte se "Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola"!

Nuk do ta analizoj funksionin e identifikimit me një figurë heroike të tërësisë sonë kombëtare, sepse kjo do të kërkonte një hapësirë shumë më të madhe. Mjafton të thuhet se nuk mund të gjendet shembull më të bukur të ideologjisë kombëtare se ky rast, ku fshihen të gjitha dallimet klasore, rajonale,

në thelb ideologjinë kombëtare

fetare, gjinore dhe futen në një kategori: të gjithë shqiptarët janë një!
Pikërisht ky aspekt ideologjik i Shqipërisë pati ndikim shumë të madh te shqiptarët në Jugosllavi. Nëse u hedh një sy aktakuzave dhe aktgjykimeve të grupeve të dënuara gjatë periudhës për të cilën flasim, do të bindesh se nuk mund të gjesh asnjë akuzë që dikë e ngarkon si pjesëtar i një organizate të majtë, por nacionalizmi shqiptar dhe irredentizmi (synimi për t'u bashkuar me Shqipërinë) janë akuzat kryesore.
Për organizatat që vepronin fshehtas në Jugosllavi, përdorimi i terminologjisë "marksizëm-leninizëm" duhet të shihet në dy aspekte: synimi i bashkimit me Shqipërinë dhe përdorimi i literaturës marksiste-leniniste për t'i organizuar strukturat në një vend ku nuk kishe mundësi të organizohej haptas siç veprohet tani. Kur flasim për këtë aspekt, nuk duhet të harrohet se Marksi, dhe sidomos Lenini, me veprën e famshme të titulluar "Ç'të bëjmë?", i përcaktojnë mënyrat e veprimit të organizatave të fshehta në sistemet politike totalitare. Fatkeqësisht, komunistët e atëhershëm jugosllavë të përkatësisë shqiptare, të cilët për të dështuar veten se ishin besnikë të frymës së vëllazërim-bashkimit, bënë krimet më të rënda kundër popullit të vet, sot, të konvertuar në "demokratë", apo pjella e asaj fryme komuniste sllave, vjellin vrer kundër manifestimeve të vitit 1981, sepse motivi real i tyre qëndron në faktin se ato demonstrata ua prishën vëllazërimin dhe bashkimin me shkije dhe shkina.

"Epoka e re": *Si i vlerësoni ato ngjarje nga kjo perspektivë kohore? A ishin kthim mbrapa, siç pretendojnë komunistët shqiptarë të linjës jugosllave, apo hapën rrugë për avancimin e çështjes sonë kombëtare?*
Mahmuti: Ngjarjet vlerësohen në përputhje me rezultatet përfundimtare që arrijnë. Demonstratat e vitit 1981 shënuan pikën kulmore të konfliktit ku nuk ka më kthim pas. Dinamika që ngjallën këto protesta krijoi një kontekst të përgjithshëm në kuadër të Jugosllavisë, që përfundoi me shpërbërjen e përgjakshme të kësaj federate. Nuk janë të paktë autorët që analizojnë shpërbërjen e Federatës jugosllave dhe që ngjarjet e vitit 1981 i përkufizojnë si katalizatorë të shpartallimit të Jugosllavisë. Është e kuptueshme pse komunistët shqiptarë të linjës jugosllave pretendojnë se këto ngjarje janë "kthim mbrapa", sepse kanë humbur privilegjet që kishin në atë kohë.

Liderët: Demonstratat e '81-s shënuan epokë vendimtare në historinë e Kosovës

Prishtinë, 11 mars (ER) - Drejtuesit e institucioneve shtetërore kanë përkujtuar 38-vjetorin e demonstratave të vitit 1981, duke vlerësuar se demonstratat e '81-s kanë pasur peshë të madhe në avancimin e kauzës për liri. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se pas demonstratave të vitit 1968, që shprehën hapur kërkesën për ngritjen e statusit të Kosovës në nivel të republikës, më 11 mars 1981 ka filluar një fazë e re historike. "Demonstrata e filluar nga studentët e Universitetit të Kosovës u shndërrua në vullnet dhe kërkesë gjithëpopullore për Republikën e Kosovës. Viti 1981 shënon kthesën përfundimtare të orientimit të kërkesave politike për avancimin e statusit politik të Kosovës, që pas përpjekjeve dhe sakrificave u kurorëzua me çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".
Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kujtuar demonstratat e vitit 1981, me ç'rast ka thënë se demonstratat e '81-s patën një peshë të madhe në avancimin e kauzës sonë kombëtare për lirinë e Kosovës. "Sot kujtojmë dhe nderojmë studentët e pranverës '81. Demonstratat studentore të atij viti patën një peshë të madhe në avancimin e kauzës sonë kombëtare për lirinë e Kosovës. Dëshmorët e pranverës '81 ishin emra që frymëzuan rezistencën deri në çlirimin e Kosovës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".
Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se demonstrata e 11 marsit të vitit 1981 shënon një epokë vendimtare në historinë më të re të Kosovës. "Mijëra studentë zgjodhën rrugën e paqes për ta kundërshtuar shtypjen dhe pabarazinë. Në përvjetorin e demonstratave studentore, kujtojmë të gjithë ata që guxuan të kërkonin atë që iu takonte, të drejtën e tyre dhe që i dolën zot këtij vendi, në rrugën drejt çlirimit" ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".
Edhe zëvendëskryeministri dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se demonstratat e vitit 1981 kanë shënuar kthesë të madhe në përpjekjet e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. "Sot bëhen 38 vjet nga demonstratat e marsit të vitit 1981, ku mijëra studentë, profesorë universitarë dhe qytetarë zgjodhën rrugën dhe protestuan kundër shtypjes që u bëhej nga regjimi i asaj kohe, por edhe duke kërkuar avancimin e statusit politik të Kosovës nga autonomia në Republikë. Në këtë ditë ne kujtojmë dhe nderojmë të gjithë ata protestues të cilët vendosmërisht dhe guximshëm artikuluan të drejtën e qytetarëve të Kosovës për Republikë", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".
Ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vlerësuar se demonstratat e vitit 1981 shënojnë fillimin e zhbërjes së Jugosllavisë. "Sot bëhen 38 vjet që prej organizimit të demonstratës së studentëve të Universitetit të Prishtinës më 11 mars 1981. Historianët pajtohen se ajo demonstratë shënon fillimin e një procesi të pandërprerë që çoi deri në zhbërjen e Jugosllavisë e deri në çlirimin e Kosovës", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook".

Përkujtohet beteja e Jeshkovës

Në Shtëpinë e Kulturës "Xhemajl Berisha" në Prizren, nën përkujdesjen e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të hënën është mbajtur akademi përkujtimore për nder të 20-vjetorit të betejës së Jeshkovës dhe rënies së 21 dëshmorëve të kombit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 11 mars - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, derisa ka folur për betejën e Jeshkovës në këtë akademie përkujtimore, ka përmendur edhe luftën heroike të UÇK-së në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Për betejën e Jeshkovës dhe rënien heroike të 21 dëshmorëve të kombit, ministri Gashi ka thënë se ishte dhe do të ngelë një ndër epopetë më madhështore të historisë së lavdishme të kombit tonë. "Prandaj edhe sot, në këtë 20-vjetor të krenarisë së përmotshme të betejës së Jeshkovës, të rënies së 21 dëshmorëve dhe martirëve, me plot krenari themi se djemtë dhe vajzat edhe të Brigadës 125 të UÇK-së, pra 21 dëshmorët e rënë në atë betejë, ishin luftëtarë të dritës së lirisë", ka thënë Gashi.

Ai ka shtuar se vepra e 21 dëshmorëve të rënë në këtë betejë, të cilët e përjetësuan betimin e të parëve, do të jetë frymëzim dhe krenari. "Edhe beteja e Jeshkovës, rënia e dëshmorëve të kombit, 20 vjet pas, e forcojnë ndjenjën, shpirtin e atdhetarisë shqiptare, për rolin kombëtar, historik të luftës së UÇK-së, sepse edhe para zhvillimeve ndërkombëtare të asaj kohe, veçmas para tryezave diplomatike, lindja dhe lufta e UÇK-së ishin dhe do të ngelen shkëlqimi më i ndritur mbarëkombëtar i fundshekullit XX", u shpreh ministri Gashi.

Përveç të tjerash, ministri Gashi ka folur edhe për rrugëtimin e Kosovës drejt Evropës. "Kosova dhe populli i saj, në bashkëpunim edhe me aleatët tanë, të prirë nga ShBA-ja, jemi edhe më të guximshëm, më të bashkuar, edhe më besimplotë në rrugëtimin tonë mbarëkombëtar drejt familjes evropiane. Pra, jemi gjithnjë e më pranë vlerave të demokracive dhe të qytetërimeve perëndimore. Institucionet e Republikës së Kosovës janë të vendosura që me zgjuarsi, unitet nacional dhe vendosmëri t'u përgjigjen sfidave të kohës, me objektivin që shteti i Kosovës të bëjë progres të vazhdueshëm drejt konsolidimit dhe përparimit të gjithanshëm", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq Isa Berisha, përfaqësues i Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së, ka pohuar se në këtë betejë kanë qenë shumë dëshmorë dhe kjo ishte një goditje e rëndë për UÇK-në. "Morali dhe qëllimi ishte shpëtimi nga okupatori serb. Edhe pse në atë kohë në Kosovë ishte misioni vëzhgues i OSBE-së, bishat serbe nuk kursyen asgjë. Ndonëse kemi dhimbje të madhe, familjet e dëshmorëve duhet të ndihen krenare për sakrificën e më të dashurve të tyre të cilët dhanë jetën që ne sot ta gëzojmë lirinë", ka thënë ai.

Me rastin e përvjetorit të betejës së Jeshkovës, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, i shoqëruar nga zyrtarë komunalë, deputetë, drejtorë, asamblistë dhe përfaqësues nga OVL të UÇK-së, kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule në varrezat e dëshmorëve në Landovicë, Atmaxhë dhe Jeshkovë. Në një deklaratë për media, kryetari Haskuka ka thënë se beteja e Jeshkovës është një prej betejave më të mëdha të regjionit të Prizrenit ku kanë rënë 21 dëshmorë.

Promovohet libri 'Fitorja diplomatike' i autorit Sabri Kiçmari

Prishtinë, 11 mars - Në ambientet e Fakultetit Filozofik është promovuar libri "Fitorja diplomatike: kujtime nga përfaqësimi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës" i autorit Sabri Kiçmari, libër ky që dokumenton dhe pasqyron sferën diplomatike të shqiptarëve gjatë luftës së fundit në Kosovë. Autori i librit ka paraqitur historinë me blloqet e shënimeve që ka mbajtur sa ishte përfaqësues diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dekani i Fakultetit Filozofik, Bujar Dugolli, ka thënë se autori i librit, Sabri Kiçmari, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm gjatë luftës në Kosovë. Ai ka thënë se është nder që Kiçmari është kthyer në atdhe dhe jep kontributin e tij si profesor në Fakultetin Filozofik. Sipas tij, historia dëshmon se populli shqiptar ka pasur gjithmonë trima të gatshëm për t'u sakrifikuar për të bërë më të mirën për vendin, porse tek në shekullin XX ndryshoi artikulimi i vlerave të luftës. "Sot kemi një pjesë të kujtimeve për përfaqësimin diplomatik të luftës çlirimtare të Kosovës, sidomos në vendet e Evropës perëndimore, që është vetëm një segment i vogël sepse ka shumëçka të na thotë dhe të na ofrojë profesor Kiçmari", ka thënë Dugolli.

Ndërsa vetë autori i librit, Sabri Kiçmari, ka thënë se jo rastësisht është zgjedhur dita e sotme për promovimin e këtij libri dhe vendi, Fakulteti Filozofik, në shenjë respekti për djemtë dhe vajzat që kanë organizuar demonstratat e vitit 1981. Më tutje, ai bëri me dije se në çdo takim që ka pasur me diplomatë të huaj ua ka bërë të ditur se në rrafshin institucional nuk ka rrugë tjetër përveç rrugës së çlirimit. Ai foli edhe për takimin me diplomatin gjerman Wolfgang Ischinger, që kishte ngjarë gjatë kohës sa nuk ishte zyrtarisht përfaqësues diplomatik i Kosovës. "Na mblodhi Ischingeri, përfaqësuesit e të gjitha grupeve, kanë qenë përfaqësuesit e LDK-së aty, kanë qenë edhe përfaqësuesit e qeverisë Bukoshi, Mujë Rugova ka qenë aty. Ideja e tij ishte ta testojë shkallën e komunikimit që kemi me UÇK-në. Dua ta them këtu se fokusi i vëmendjes së tij nuk ishte LDK-ja dhe as Mujë Rugova. Fokusi i vëmendjes së tij ishte çka unë po them dhe përfaqësuesi i LPK-së që atë kohë ka qenë, z. Ibrahim Kelmendi. Ka pasur edhe një komunikim interesant, kur ai (diplomati gjerman) më pyeti: 'Kur mendoni të fitoni?', i thashë: 'Ne kemi për të fituar dhe jemi shumë të sigurt dhe shumë të vendosur'. Unë dëshiroja ta paraqisja bindjen që nuk ka kush që e ndalë UÇK-në. Dhe ai më tha: 'Brenda 50 vjetëve të ardhshme, me siguri jo', e unë i thashë: 'Kur ti të jesh ende në detyrë ne do të fitojmë'", ka treguar Kiçmari bisedën me Ishinger.

Kiçmari u shpreh se dokumentet origjinale mbi të cilat është shkruar libri janë të ruajtura mirë, por theksoi se nuk është koha e duhur që të bëhet publike vendi i ruajtjes së tyre. Tutje, ai tha se shumica e takimeve me diplomatë të huaj është bërë pa ndërmjetësues.

Vëmendje të posaçme autori u kushtoi raporteve me komandantin Fehmi Lladrovci. "Mendoj se nuk ka pasur komandant më të dinjitetshëm sesa Fehmi Lladrovci për ta zëvendësuar Adem Jasharin dhe këtë mendim e kam edhe sot", ka theksuar ai. Këtë bindje Kiçmari bëri të ditur se e ka shkruar në mars të vitit 1998, teksa tha se ka ndarë pikëpamje të njëjta me komandantin Fehmi Lladrovci.

Ky libër është një përmbledhje ekskluzive e shënimeve të përfaqësuesit diplomatik të Kosovës gjatë kohës së luftës në Kosovë. (ksp)

Hoxha: Vendimi për vizat, pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se vendimi për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës mund të merret pas përfundimit të zgjedhjeve në Parlamentin Evropian. Në një konferencë për medie të hënën, ajo ka shprehur optimizëm se ky vendim do të merret në takimin e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian që do të mbahet në muajin qershor. Ministrja Hoxha ka thënë se Kosova gjendet në hapin e fundit sa i përket liberalizimit të vizave

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

Prishtinë, 11 mars - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të hënën se Kosova pret që vendimi për heqjen e vizave të merret në takimin e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian në muajin qershor i cili do të mbahet pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian. "Po shpresojmë dhe po kërkojmë që pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian të krijohet një momentum i ri dhe në takimin e qershorit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian të kemi një vendim", ka deklaruar ministrja Hoxha, duke shtuar se Kosova gjendet në hapin e fundit sa i përket liberalizimit të vizave meqë janë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara për këtë proces. Ajo ka thënë se tani është faza ku shtetet anëtare të Bashkimit Evropian duhet të votojnë veç e veç për çështjen e liberalizimit të vizave dhe, sipas ministres Hoxha, shtetet e Bashkimit Evropian po presin të përfundojnë zgjedhjet në Parlamentin Evropian dhe më pas të marrin vendim. "Duke parë që jemi në prag të zgjedhjeve në Parlamentin Evropian, asnjë prej shteteve anëtare nuk janë optimiste që do të mund të lëvizim përpara para këtyre zgjedhjeve", ka deklaruar ministrja Hoxha në një konferencë për medie pas takimit me ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi.

Në këtë takim ministrja Hoxha dhe ministri Matoshi kanë diskutuar për rëndësinë e projekteve të Bashkimit Evropian në zhvillimin e gjithëmbarshëm të vendit, me theks të veçantë në përmirësimin e mjedisit. Hoxha ka thënë se qëllimi i tyre i përbashkët është që të rritet përkushtimi dhe dinamika për përmirësimin e gjendjes mjedisore në Kosovë. "Ndërtimi i deponisë për mbetje të rrezikshme, dekomisionimi i 'Kosovës A' dhe instalimi i filtrave për 'Kosovën B', janë projekte që kalojnë shumën mbi 100 milionë euro", ka theksuar ministrja Hoxha, duke shtuar se Ministria e Integrimit si dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë të përkushtuara që sa më parë të zbatohen këto projekte.

Duke folur për fondet IPA 2016 dhe IPA 2017 ajo ka thënë se të dyja kontratat janë duke u zbatuar sipas planeve dhe se Kosova nuk është duke humbur asnjë cent nga fondet e Bashkimit Evropian. "Jemi plotësisht brenda afateve kontraktuale dhe se Kosova nuk ka humbur as edhe një cent të vetëm në këtë drejtim. Më së largu deri kah qershori 2019, Bashkimi Evropian do ta fillojë vlerësimin e përmbushjes së indikatorëve të paraparë në këto kontrata për të filluar ndarjen e mjeteve financiare. Prandaj më lejoni t'ju informoj se Kosova nuk ka humbur as edhe një cent të vetëm nga Bashkimi Evropian, përkundrazi prej se kam marrë këtë post, fondet e BE-së vetëm sa janë rritur e asesi nuk janë zvogëluar. Fondet e BE-së për Kosovën vetëm sa janë rritur si: IPA 2017 ka ndarë 73 milionë euro, IPA 2018 ka ndarë 90.5 milionë euro, kurse IPA 2019 - 2020 mbi 200 milionë euro ", është shprehur Hoxha.

Ndërkohë ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka folur për bashkëpunimin në mes dy të ministrive sa i përket zbatimit të direktivave të Bashkimit Evropian që lidhen me fushat që mbulon MMPH-ja. "Në takimin me ministren e Integrimeve Evropiane, Dhurata Hoxha, kemi diskutuar për shumë tema dhe projekte. Ndër to ka qenë edhe ndërrimi i filtrave të 'Kosovës B', ndërtimi i deponisë në Fushë-Kosovë për materiet e klasifikuara si të rrezikshme, për fondet ndërkufitare me Shqipërinë, për projektet e deponisë së Mirashit, deponisë në Pejë dhe shumë projekte të tjera që janë të planifikuara me fondet e IPA-së", ka deklaruar ministri Matoshi. Ai është zotuar se nuk do të lejohet të humbet asnjë cent nga fondet e IPA-s sepse, sipas Matoshit, këto fonde mbështesin projekte jetike për Republikën e Kosovës. "Janë projekte dhjetëramilionëshe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve të Kosovës, sidomos ato të mjedisit. Ne nuk e kemi luksin dhe nuk do të lejojmë në asnjë mënyrë që këto fonde të rrezikohen. Janë projekte jetike për Kosovën dhe ne si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të bëjmë gjithçka që është e mundur që këto projekte të avancohen përpara", ka theksuar ministri Matoshi.

Presidenti Thaçi pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i Katarit

Prishtinë, 11 mars (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të hënën letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Katarit për Kosovën, Ali bin Hamad Al Marri. Presidenti Thaçi fillimisht e ka uruar ambasadorin për detyrën e re dhe i ka ofruar mbështetje të plotë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Në këtë takim është diskutuar për mundësitë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimit tregtar, ku shumë shpejt pritet të ketë edhe jetësim të projekteve konkrete në këtë fushë. "Katari e ka mbështetur Republikën e Kosovës në procesin e njohjeve dhe të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Për këtë do t'u jemi gjithmonë mirënjohës", ka thënë presidenti Thaçi. Ndërsa ambasadori Ali bin Hamad Al Marri ka thënë se Katari do të jetë gjithmonë përkrah Kosovës. Presidenti Thaçi ka thënë se shumë shpejt Kosova do ta hapë ambasadën në Doha dhe kjo do ta mundësojë thellimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat.

Kosova, adresë e besueshme për investime amerikane

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 MARS - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim delegacionin e investitorëve amerikanë, të kryesuar nga Michael Mintz, themelues dhe shef ekzekutiv i kompanisë "Squared Property Group LLC", me të cilët ka biseduar mbi situatën aktuale ekonomike në vend, duke thënë se Kosova ka krijuar klimë tejet të favorshme për investimet e huaja. Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka theksuar se me rritjen ekonomike më të madhe në rajon, zvogëlimin e tarifave tatimore, reformat thelbësore në sundim të ligjit dhe ato fiskale, si dhe me Ligjin për investime strategjike, Kosova ka hyrë në hartën e vendeve atraktive dhe të sigurta për investitorët e huaj. "Kosova tashmë e ka Ligjin për Investime Strategjike, që krijon lehtësira dhe kushte të mira për investitorët e huaj. Janë themeluar tri zona të veçanta ekonomike të gatshme për t'i pritur investitorët e huaj", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke përmendur edhe projektet e mëdha energjetike, ato të energjisë alternative.

Ndër të tjera, gjatë bashkëbisedimit me këtë delegacion kryeministri Haradinaj ka shtuar se Kosova tashmë është kthyer në një adresë të besueshme për investime amerikane. Nga ana e tyre, delegacioni i investitorëve amerikanë falënderoi kryeministrin Haradinaj për pritjen, duke shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit mes tyre. Edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur delegacionin e bizneseve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i kryesuar nga konsullja e Kosovës në ShBA, Teuta Sahatqija, me të cilin ka diskutuar rreth sektorit të teknologjisë informative dhe komunikimit (TIK), sektorit të energjisë dhe klimës të të bërit biznes në Kosovë.

Ministri Lluka i ka informuar se Kosova ka një sistem fiskal shumë të favorshëm për biznese, është një qendër lidhëse në Evropë dhe se Banka Botërore e ka cilësuar si vendin e dytë në rajon në raportin e të bërit biznes. "Kosova ka një sistem fiskal shumë të favorshëm për biznese, është vendi me borxhin më të vogël publik përshtatur GDP-së, është urë lidhëse me vendet e Evropës dhe ka qasje në tri porte detare, atë të Selanikut, të Durrësit dhe të Malit të Zi. Në raportin e të bërit biznes Kosova radhitet e 40-ta në botë dhe e dyta në rajon", u shpreh ministri Lluka. Ai ka shtuar se sektori i TIK-ut është i vetmi sektor në Kosovë i cili ka bilanc tregtar pozitiv. "Sektori i teknologjisë informative është sektor i cili ka bilanc tregtar pozitiv dhe është sektor në të cilin kompanitë vendëse kryejnë shërbime 'outsource' për kompanitë në Evropë, ShBA dhe më gjerë. Pra, është sektor në të cilin truri nuk ikën nga vendi", ka deklaruar Lluka.

Kreu i MZhE-së delegacionin e bizneseve nga ShBA-ja e ka informuar rreth "Tech Park Prishtina" dhe "Training and Innovation Park" në Prizren, ku parashihet të krijohen qendra për trajnime dhe qendra të ekselencës digjitale në të cilën do të trajnohen bizneset dhe të rinjtë e vendit. Përfaqësuesit e delegacionit gjithashtu u interesuan rreth sektorit të energjisë, zhvillimeve dhe projekteve të cilat janë duke u zhvilluar. Ministri Lluka u ka thënë atyre se Kosova ka synim përmirësimin e gjendjes së furnizimit me energji elektrike dhe këtë e dëshmon fakti i nënshkrimit të marrëveshjes me kompaninë "Countur Global" për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", si dhe rreth mënyrave të gjenerimit të energjisë nga mbeturinat.

Punëtorët e 'Infrakos'-it mbajnë grevë njëorëshe

PRISHTINË, 11 MARS - Punëtorët e ndërmarrjes publike "Infrakos" të hënën kanë mbajtur grevë njëorëshe për shkak të vonimit të lëshimit të subvencioneve nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Kryeshefi ekzekutiv i Infrakosit, Agron Thaçi, ka thënë për "klankosova.tv" se Sindikata ka kërkuar edhe rritjen e pagës dhe përmirësimin e kushteve të punës. "Ka pasur ndërprerje të punës për një orë. Arsyeja ka qenë për shkak të vonesës së lëshimit të subvencioneve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kërkesa e Sindikatës është rritja e pagës dhe përmirësimi i kushteve të punës. Ne bashkë me Qeverinë do të shohim në vazhdim për realizimin e këtyre kërkesave", ka thënë Thaçi. Kërkesë e punëtorëve është edhe që t'iu paguhet norma e plotë e orëve të punës gjatë fundjavës, të paguhet shujta e ushqimit dhe të bëhet pagesa e trustit pensional. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të tyre, punëtorët paralajmërojnë edhe shkallëzim të grevës.

Bizneset ankohen për monopolizim të tregut të energjisë

Drejtuesit e tri odave më të mëdha ekonomike në vend, Berat Rukiqi, Arian Zeka, dhe Astrit Panxha, në një konferencë për medie kanë shprehur shqetësimet e komunitetit të biznesit rreth problemeve me energji elektrike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 11 mars - Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Odës Ekonomike Amerikane (OEAK) dhe Klubit të Prodhuesve, në një konferencë për medie të hënën kanë ngritur shqetësimin e tyre për mohimin e vet konsumimit të energjisë elektrike dhe liberalizimin e tregut të energjisë. Për këtë të fundit ata kanë kërkuar mos të fillojë më 1 prill pasi nuk është liberalizim i tregut, por monopol.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se janë dy çështje që bizneset i kanë ngritur: mundësia e vet konsumit të energjisë, që është një ndalesë e cila nuk ka bazë teknike dhe juridike për refuzim, por që e ka refuzuar rregullatori, dhe çështja e tregut të energjisë, ku prej 1prillit pritet liberalizimi i energjisë. Sipas tij, bizneset kanë kërkuar vëmendjen e tyre dhe të institucioneve pasi, nëse nuk zgjidhen këto probleme në një afat të shkurtër kohor, atëherë rrezikohet funksionimi i këtyre bizneseve. "Po del se nuk ka liberalizim praktik. E vetmja kompani që ka mundësi për të qenë në treg është kjo që kemi, KESKO. Nuk ka mundësi as KEK-u dhe as kompanitë e tjera të licencuara për të pasur mundësi që t'u shesin rrymë kompanive që u është kërkuar për të dalë në treg të hapur", ka deklaruar Rukiqi, duke shtuar se kërkojnë veprim të shpejt për zgjidhje të dy çështjeve. "Sidomos kjo çështja e tregut që lidhet më 1 prill, nëse nuk zgjidhet deri me këtë datë, atëherë besoj se shumica e bizneseve nuk kanë llogari të punojnë për shkak se kostoja, fatura e energjisë pas 1 prillit do të jetë 30 deri në 40 për qind më e lartë sesa që e paguajnë sot", është shprehur ai.

Kurse drejtori ekzekutiv i OEAK-ut, Arian Zeka, ka thënë se në vend se të shihet një përmirësim në tarifat e energjisë, po shihet përkeqësim i kësaj gjendje. "Ne vetëm po e përkeqësojmë edhe më tej ambientin e të bërit biznes", ka thënë Zeka.

Sa i përket liberalizimit të tregut, Astrit Panxha nga Klubi i Prodhuesve ka kërkuar që ky vendim të shtyhet edhe për një vit. "Ne kërkojmë që të shtyhet vendimi i liberalizimit të tregut për së paku një vit", u shpreh Panxha, duke shtuar se rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ketë ndikim në uljen e eksportit dhe rritjen e importit.

MZhE-ja ndan 67 mijë euro për përmirësimin e ndriçimit publik

Prishtinë, 11 mars (ER) - Duke u nisur nga interesi i përbashkët për t'i koordinuar aktivitetet e ndërlidhura për sektorin e energjisë, në veçanti promovimin e efiçiencës së energjisë, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, me synim të përmirësimit të ndriçimit publik. Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të ofrojë përkrahje prej 67 mijë eurosh për Komunën e Kamenicës me qëllim që të përmirësohet ndriçimi publik në këtë komunë, ndërsa Komuna e Kamenicës do të ofrojë 7 000 euro për këtë projekt. Me nënshkrimin e këtij memorandumi synohet krijimi i mundësive për implementimin e pilotprojektit "Promovimi i efiçiencës së energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të efiçiencës së energjisë". Ky memorandum bashkëpunimi është pjesë e zbatimit të Planit Nacional për Efiçiencë të Energjisë, e që kontribuon në përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

ATK-ja vazhdon ndëshkimin e subjekteve të lojërave të fatit që nuk respektojnë ligjin

Prishtinë, 11 mars (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), përkatësisht Divizioni i Lojërave të Fatit, gjatë javës së shkuar, nga vizitat e rregullta në terren, por edhe nga informacionet e pranuara nga qytetarët, ka zhvilluar 30 aktivitete ku si rezultat janë mbyllur 11 lokale të lojërave të fatit të cilat aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar duke mos iu përmbajtur kritereve të Ligjit për Lojërat e Fatit. "Nga parregullsitë e konstatuara janë lëshuar 13 gjoba në vlerë 54 000 euro. Përveç gjobave. janë konfiskuar edhe dy pajisje të kësaj veprimtarie. Divizioni i Lojërave të Fatit do t'i vazhdojë aksionet e tilla në çdo kohë bazuar në autorizimet që i jep Ligji Nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit. Gjithashtu, u bëjmë thirrje qytetarëve të raportojnë në ATK rastet për të cilat dyshohen se ushtrojnë veprimtarinë e lojërave të fatit jashtëligjshëm", është thënë në njoftimin për media.

Janë 100 arsye pse ka qenë e arsyeshme taksa 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

I tëri ai presion i panevojshëm për taksën: Çështja e taksës u bë përrallë duke u shndërruar në armë, jo për ta luftuar Serbinë, por njëri-tjetrin. Jemi dëshmitarë se PDK-ja, botërisht, përmes nënkryetarit dhe mbijetuesit të të gjitha regjimeve brenda kësaj partie, Enver Hoxhës nga Gjiro - Reka ka marrë atësinë, mëmësinë dhe autorësinë për këtë taksë, deri në çastin kur është dashur të paguhen faturat e ardhura nga ShBA-ja, Makaroni i Francës, Kuraci i Austrisë dhe mashtruesit e pamoralshëm të Brukselit, Johanes Han, ky violinist i punëve të kota dhe mafiozja parapolitike, Federika Mogerini. Sa u ngritën temperaturat, babai biologjik i taksës po sillet si adoptues i taksës duke u dëshmuar si baba i pandërgjegjshëm dhe i papërgjegjshëm. Kryeministri Haradinaj po i qëndron taksës së vendosur nga të tjerët më shumë se ai të ishte autor i saj. Të gjithë që kemi dëgjuar për politikën e që sillemi sikur të jemi politikanë pa të cilët politika globale as që mund të paramendohet, e kemi të qartë se vendosja e kësaj takse ka qenë një blof, me afat të caktuar përdorimi, pa pretendime se do të përmbyset rendi botëror. Ka qenë një veprim puro politik, i mbështjellë me një cipë të interesit ekonomik. Askush nuk e ka menduar se kjo taksë do të ketë jetë të gjatë, jo më shumë se disa ditë apo disa javë. Që në fillim, kundër taksës kanë reaguar ashpër, vojvoda Aleksandar Vuçiq, Ivica Daçiq, Vulin Drakulla, lobistët e Serbisë, Johanes Han dhe Federika Mogerini, dyshi mashtrues dhe i pamoralshëm, ndërsa më vonë edhe Makaroni i Francës, Kuraci i Austrisë, Bolton bin Trapi ndërsa, nga vendorët, ishin Ramiz Boro Kelmendi, presidenti legjendar Xhavit Mosadi dhe disa shpageti politikanë që nuk kanë peshë as në skenën politike të Tanzanisë e lëre më të Kosovës.

Për mua ka qenë përcaktues lëvizja e Enverit nga Gjiro - Reka sepse, as Kadria nuk bën asgjë pa folur shoku Enver. Dhe shoku Enver tha troç dhe pa ekuivokë (duhet ta pyesë Hidën për kuptimin e kësaj fjale) se taksa duhet të pezullohet pasi e paska arritur efektin politik. Kadria pastaj ia shtoi 120 ditë e që u përkrah nga krejt PDK-ja e Hashimit. Heqja apo pezullimi i taksës për mua nuk ka asnjë dallim, po kërkohet për shkak të ruajtjes së miqësisë së përjetshme (që nuk e keni të garantuar as me gruan edhe pas 100 vjetësh martesë) me Amerikën e që në raste të caktuara është nënshtrim, nën çdo dinjitet. Kryeministri Haradinaj nuk e hoqi taksën dhe, deri më tani, pa asnjë dyshim, del të ketë pasur të drejtë. Taksa është veprim politik, prandaj edhe efektet, si pozitive ashtu edhe negative, prodhojnë rezultate politike. Kush merret me politikë është normale të pretendojë përfitime politike. Këtë të drejtë e kanë pasur Enveri dhe Kadria, e pse mos ta ketë edhe Ramushi?! Edhe Hashimi, me kotillën politike që e shoqëron, me taksë po bën shumë politikë duke e përdorur si kallauz për vazhdim të bisedimeve me çetnikun Vuçiq. Edhe ndërkombëtarët po bëjnë politikë me taksën 100 për qind duke i bërë favore Serbisë dhe Bosnjës dhe duke e nënshtruar Kosovën deri në përbuzje. Ramush Haradinaj e ka bërë punën me taksën ashtu si duhet, e ka kthyer dinjitetin e nëpërkëmbur kombëtar dhe shtetërorë, e ka forcuar pozitën negociuese të Kosovës, ka dëshmuar edhe para ndërkombëtarëve një shtyllë kurrizore politike, kombëtare dhe shtetërore por se synimin e ka shumë ambicioz; se nuk hiqet taksa pa njohje nga Serbia. Jemi dëshmitarë se Ramushi është lënë i vetmuar dhe se nuk ka përkrahje të gjerë politike prandaj të gjitha kritikat apo më mirë të them kërcënimet ndërkombëtare po adresohen te ai kurse, këta, pontpilatët tanë duan t'i lajnë duart nga veprimet që vet i kanë bërë e tash nuk duan të marrin përgjegjësi për këtë! E keni të qartë se edhe sekretari i NATO-s, Jovan Stoltenberg, në mbrojtje të keksit Plazma dhe ujit Rosa, është kërcënuar fuqishëm ndaj Ramushit dhe Kosovës. I ultë fort ky farë kërcënimi, i padinjitetshëm krejt. Taksën prej 100 për qind për mallrat nga Serbia e Vuçiqit dhe Bosnja e Dodigut e kam konsideruar si masë të përkohshme prandaj kam sugjeruar dhe sugjeroj edhe sot që kjo masë të pezullohet dhe të zëvendësohet me një masë tjetër ndaj Serbisë. Po e shihni që Serbisë nuk i pëlqen asnjë propozim nga Kosova kurse taksën e përdorë si arsyetim për lobim kundër Kosovës. Po të isha në vend të Ramushit, taksën prej 100 për qind do ta pezulloja apo hiqja krejtësisht dhe këtë vendim do t'ua ktheja baballarëve dhe nënave të kësaj takse, shokut Enver dhe Kadrisë si dhe presidentit legjendar, pastaj edhe kurtizaneve politike të LDK-së si dhe makros, Gjat Colli dhe Ramiz Boro Klementi. Ata, në konsultime brendapërbrenda do të përcaktonin se kush është baba e kush nënë e kësaj takse! Mos t'ju habit pamja fizike sepse në mesin e të apostrofuarve ka shumë biseksualë moral, njerëzorë dhe politikë. Në vend të taksës, kryeministri Haradinaj duhet të insistojë në kushtet për dialog që janë përfshirë në Platformën për bisedime e të cilat Vuçiqit po i shkaktojnë ankthe dhe makth të natës por edhe të ditës! Në takim me ndërkombëtarët më nuk duhet të mbrohet taksa por Platforma për Bisedime. Kjo Platformë nuk i përshtatet as Vuçiqit, as presidentit legjendar, as mashtruesve të Brukselit e duket e as qarqeve rreth Bolton ibn Trap. Pas gjithë kësaj dhe pas të gjitha këtyre presioneve, në kundërshtim me çdo standard moral, është në sprovë morali ynë qytetarë; duhet 100 për qind të bojkotojmë mallrat nga Serbia, duhet 100 për qind t'i bojkotojmë ata që importojnë dhe shesin këto mallra, duhet të blejmë prodhime vendore apo prodhime të atyre vendeve që kanë qëndrim normal ndaj Kosovës. Çfarë kuptimi ka taksa 100 për qind për këto mallra nëse vetëdija jonë është në kundërshtim me qëllimet e kësaj takse?! Mund të na detyrojnë ta pezullojmë taksën por nuk mund të na detyrojnë të blejmë mallra nga shteti fashist i Vuçiqit dhe dominioni shovinist i Dodigut!

Pse kërkohet pezullimi i taksës për 120 ditë: Lajmet e rreme apo fake news janë arma kryesore që përdoret, sidomos në republikat e bananeve siç është Kosova. Ato sforcohen në përputhje me qëllimet e synuara: sa më të mëdha të jenë synimet, aq më të mëdha janë këto rrena! E tillë ishte një rrenë se, po nuk e hoqët taksën, do të hiqet kampi Bondsteel e pastaj, vaj halli për Kosovën dhe qytetarët e saj! Kjo rrenë burimin e ka në Kosovë, nga politikanët e vendit të cilët kanë llogaritur se, me ta bërë publik këtë të keqe të madhe që i kanoset Kosovës, nuk na mbetet asgjë përveç se kryeministrin Haradinaj ta varim publikisht në Sheshin e Trerremëshit komunist e që nuk deshën apo nuk guxuan ta bëjnë Sheshi "Adem Jashari". Realisht, këtë varje të kryeministrit Haradinaj nuk e konsideroj si veprim fizik por politik - varje politike ndonëse, edhe në majat e politikës kosovare ka të tillë që vullnetarisht do ta varnin edhe fizikisht Ramushin! Afati i kërkuar prej 120 ditëve është periudhë kur është planifikuar dhe mendohet të arrihet marrëveshja e imponuar me Serbinë, në dëm të Kosovës. Prandaj po kërkohen 120 ditë besë për një pabesi dhe punë kundër popullit dhe kundër shtetit. Kjo është si puna e gomarit, të gjithë po e shohim çka po ndodhë por po lutemi të jemi në ëndërr! Me këtë marrëveshje, Serbia përfundimisht po e zgjedhë çështjen shqiptare duke e pastruar edhe Luginën e Preshevës në ndërkohë që veriun e Kosovës e ka spastruar dhunshëm nga shqiptarët kurse, më shumë se 80 për qind të serbëve po i lë brenda Kosovës, me të drejtat e Pakos së Ahtisarit, me mundësi vetoje, me zona të mbrojtura si potencial strategjik destabilizues. Kosovën po e trajtojnë si rast të izoluar. Jam kundër përkufizimit në baza etnike mirëpo nëse këta tereqët e vendit dhe ndërkombëtarë e bëjnë këtë atëherë jam për atë që Kosova të mos ketë asnjë përgjegjësi për serbët e mbetur e as për zona të mbrojtura apo të drejta të rezervuara. Këtu duhet të zbatohet reciprociteti absolut; sa shqiptarë vazhdojnë të jetojnë në Serbi, aq serbë duhet të mbesin në Kosovë, me të drejta të njëjta, pa asnjë diskriminim, as pozitiv e as negativ. Të gjitha të drejtat duhet të rregullohen me dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kosova po trajtohet si rast i izoluar dhe pozicioni i saj ka degraduar shumë në planin ndërkombëtarë në saje të presidentit Hashim Thaçi dhe analfabetit diplomatik, Behgjet Pacollit të cilët kanë formuar rrathët e interesit me vlerën identifikuese, injorancën dhe mungesën e skajshme të çdo përgjegjësie! Po të ishte Kosova një vend normal, me shoqëri civile normale, media normale, deputetë të përgjegjshëm, institucione të pavarura e që punojnë mbështetur në ligj, në çastin kur presidenti Hashim Thaçi ka

→

Malisheva fillon ciklin e ligjëratave nëpër shkolla për mbrojtje nga rriqrat

Malishevë, 11 mars (ER) - Këshilli i Drejtorëve në Komunën e Malishevës ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt, e cila është drejtuar nga nënkryetari i kësaj komune, Hajdin Berisha. Në këtë mbledhje Berisha ka kërkuar nga drejtorët komunalë të raportojnë për punët e kryera gjatë javës së kaluar, për detyrat të cilat do të fillojnë që nga dita e sotme të realizohen për javën dhe muajin mars në tërësi.

Fillimisht drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka raportuar për disa aktivitete të kësaj drejtorie. "Me rastin e dhunës fizike që ndodhi ditë më parë në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Afrim Krasniqi' në fshatin Bardh, në mes të një mësimdhënësi dhe nxënësi, drejtoria ka shqiptuar masën e suspendimit të mësimdhënësit që përdori dhunë fizike ndaj nxënësit deri në një vendim të ri që do të merret nga organet e drejtësisë", ka thënë Thaçi.

Ndërsa Liridon Hoti, drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka bërë me dije se nga 13 marsi do të fillojnë ligjëratat nëpër të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sensibilizohen nxënësit për mbrojtjen nga virusi kundër Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHHK). Në këtë kontekst, ai ka thënë se shumë shpejt do të fillojë edhe repelimi i kafshëve. Në vazhdim të raportimit, edhe Valon Gashi nga Drejtoria për Shpëtim dhe Mbrojtje ka bërë me dije se brenda këtij muaji në Malishevë ka pasur mbi 45 vatra të zjarrit në fusha dhe

male. Në fund të takimit, nënkryetari Hajdin Berisha ka kërkuar nga drejtorët përmbushjen e të gjitha objektivave sipas dinamikës së planifikuar për projektet që janë paraparë dhe që do të realizohen.

negociuar për kufij (shkëmbim territoresh, korrigjim të rëndë apo të lehtë, përmirësim të kufijve e marrëzira të ngjashme që janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës), menjëherë është dashur të shkarkohet dhe të vihet para përgjegjësisë ligjore. Fatmir Sejdiu, ish-president dhe Behgjet Pacolli, president i Hashimit (sepse, sipas Kushtetutës nuk ka qenë president), kanë bërë shkelje shumë më të vogla se presidenti Thaçi dhe janë detyruar të dorëhiqen. Tash, po e përmend Hashim Thaçin me të cilin nuk kam asgjë personale, sepse është president dhe po negocion pa pasur mandat për të biseduar për ato tema dhe kështu do të veproja edhe po të ishte president edhe Babushi im, Shaban Shala, ndjesë pastë që më ka bërë këmbë e duar dhe me këto pak mendë që i kam. Kurrë Kosova nuk ka qenë në pozitë më të pafavorshme negociuese se që është tani. A ka qenë dhe a është normale të bisedoni për kufij 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe 11 vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës?! Nuk është dhe kjo çmenduri nuk duhet të përkrahet në asnjë kontekst! Nëse duan lojën me kufij atëherë po e fusim këtu edhe Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë, Shqipërinë dhe Greqinë. Le të zgjidhet një herë e mirë çështja e shqiptarëve të cilët me vullnetin e tyre do të kishin të drejtë të deklarohen se ku dhe me kë duan të jetojnë! Për mua, në këtë situatë që jemi është hipokrizi kërkesa e LDK-së dhe LV-së për zgjedhje të parakohshme për faktin se po na rrezikohet koka dhe ekzistenca e ju po flisni si ta mbrojmë këmbën dhe prapanicën! Kjo situatë mund të parandalohet, nëse mund të parandalohet vetëm me protesta të përditshme duke krijuar një masë kritike të protestuesve që do të kundërshtonin me çdo kusht dhe me çdo çmim aventurat e Vuçiqit, Thaçit, dyshit zhvatës nga Brukseli apo edhe kooperativa Trap ibn Bolton! Çdo zgjedhje e ngutshme dhe e shpejtë domosdoshmërisht përcillet me gabime që nuk mund të riparohen kurrë më!

Thirrje për luftë: Çetniku permanent demokrat, Aleksandar Vuçiq deklaron se Serbia do të ndërhyjë ushtarakisht vetëm në rast se shqiptarët do t'i vrasin serbët. Çfarë deklaratë idioteske! Po serbët e Kosovës jetojnë shumë më mirë se ata të Serbisë, me 22 vota bëhen deputetë të Kuvendit të Kosovës, bëhen ministra të qeverisë duke punuar për Serbinë dhe këtë punë E konsiderojnë si fakultative; kur të duan, me muaj të tërë refuzojnë të punojnë për shkaqe politike por i gëzojnë të gjitha beneficionet sikur të ishin në vijën e parë të frontit në mbrojtje të Pavarësisë së Kosovës, në vend se t'u tregohet vendi! Vjedhin sa të duan dhe kujt nuk i përgjigjen sepse nuk i njohin gjykatat e Kosovës. Edhe kur kapen me pelë për dore, pas një konference të Vuçiqit , lirohen menjëherë! Vojvoda i matufosur Sheshel, ka dëshirë të luftohet në Kosovë por duke e ruajtur prapanicën dhe kërkon që për Serbinë të luftojnë në Kosovë rusët dhe kinezët. Pasardhësi origjinal i kontit Drakulla, Aleksandar Vulin, si ministër i mbrojtjes në Serbi vetëm është në pritje të urdhrit të komandantit suprem e të ndërhyjë ushtarakisht në Kosovë në ndërkohë që hynte në Kosovë i naskuar si pop i kishës dhe rrugëve tretësore vetëm të mos kapet nga policia e Kosovës. I ka treguar Gjuriqi se si u nda në luftë me Policinë e Kosovës, pasi ndërhyri "ushtarakisht" në Kosovë. Kjo dëshmon se krimineli gjithmonë kthehet në vendin e krimit dhe aty e ka fundin. Nëse këta tre kriminelë kanë motiv dhe guxim të vinë në Kosovë dhe të luftojnë, pse atëherë ne nuk kemi motiv të luftojmë dhe vdesim për vendin tonë! Provojeni zotërinj! Tash, pas paraqitjes ademjashariste të Hashim Thaçit në Tiranë, aspak nuk po kam frikë nga kërcënimet e Serbisë! Presidenti Hashim Thaçi dhe botërisht se askush nuk mund ta marrë as edhe një milimetër të vetëm të territorit të Kosovës pa kaluar mbi trupin e tij dhe të gjithë ata që e njohin Hashim Thaçin e kanë të qartë se është i fjalës dhe se, në çdo kohë është i gatshëm për një sakrificë sublime, së bashku me komandantin e forcave të armatosura të Madagaskarit, Behgjet Pacollin. Unë i besoj plotësisht presidentit Thaçi ndërsa është e drejtë juaja të mendoni siç mendoni!

Harakiri dhe sajonara: Harakiri është veprim fisnik i samurajëve në Japoni, që bëjnë vetëvrasje me shpatë kur është dashur të mbrojnë nderin dhe për qëllime të larta dhe, në fjalorin modern është keqpërdorur duke e identifikuar me një vetëvrasje të pamotivuar siç është lufta për pushtet apo për motive të ulëta. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli ka shkuar në Japoni dhe besoj se pas kthimit, nëse mbetet nën tutelën e Hashimit, harakirin politik e ka të pashmangshëm. Kadri Veseli duhet ta ndërtojë personalitetin prej lideri duke sfiduar edhe Zeusin e Kosovës, Hashim Thaçin. Në të kundërtën, e pati puna e tij politike dhe lirisht mund t'i bashkëngjitet ndonjë OJQ-je. Tash është momenti që Kadri Veseli, duke mos lëshuar pe asnjë milimetër për kufijtë e Kosovës të ngritët mbi veten, jo për ta luftuar Hashimin apo për ta përkrahur Ramushin por për të respektuar dhe mbrojtur të kaluarën dhe gjakun e derdhur të dëshmorëve të kombit . Ky angazhim, për mua i vetëm dhe i domosdoshëm nuk e largon të qenit politikan modern apo nuk e vë në pozicion armiqësie me amerikanët apo miqtë ndërkombëtarë. Sot, të jesh në pozitë armiqësie kundër një çetniku sikur është Vuçiqi dhe një Serbie fashiste është detyrim i çdo politikani kosovar, pavarësisht përkatësisë etnike dhe bindjeve politike! Nuk duhet të lakmojmë asgjë të huaj por nuk duhet të japim asgjë tonën! Nuk po kërkojmë të pamundurën por duam ta mbrojmë të mundshmen dhe duhet ta mbrojmë këtë! Sot, në rrethanat ekzistuese, më mirë është t'i thuhet sajonara (lamtumirë) politikës, sesa të bësh hara - kiri të shtetit të Kosovës duke ia prekur kufijtë! Së shpejti, madje shumë shpejt do të shohim se kush do të bëjë harakiri e kush do të thotë sajonara! Grupi për negociata që aq shumë po i pengon Vuçiqit dhe Serbisë saqë u takuan me të gjithë popat e Serbisë për një qëndrim të përbashkët, edhe pse së paku 50 për qind i këtij grupi është i kriminalizuar, antikombëtar dhe joprofesional, duhet të përkrahet, jo shkaku i anëtarëve por shkaku i përmbajtjes së Platformës që, ka të meta por është mjet efikas për frenim të proceseve të mëdha të dëmshme për Kosovën. Serbisë nuk po i pëlqen asnjë format i bisedimeve përveç modeli hashimist që e ka bërë punën lesh në të gjitha anët duke i premtuar territore Serbisë përmes korrigjimit të kufijve. Në momentin kur ka kushte, Vuçiqi po çartet sikur edhe miqtë e Serbisë në me krye dyshen mashtruese të Brukselit. Nuk është në rregull që Platforma të mos i pëlqejë Vuçiqit dhe Serbisë dhe, po e njëjta Platformë të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese nga LDK-ja dhe LV-ja. Diçka nuk po ma kapë truri!

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

REPUBLIC OF KOSOVO

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Procurement Name: **Supply of project management-, air quality information management, behavior change and communication services**

Procurement Reference: RFP / MFK /2019/ QCBS / No. 006

Prishtina, Kosovo
11 March 2019

1) The Government of Kosovo has received grant funding of UD$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works, and Services.

2) The Threshold Program in Kosovo is a $49 Million grant that consists of two projects, the Reliable Energy Landscape Project and the Transparent and Accountable Governance Project:

a) Reliable Energy Landscape Project: Demand for electricity significantly surpasses supply in Kosovo, and the country struggles with the reliability of its energy supply. This project encourages greater household energy efficiency and facilitates the switch to non-electric sources of heating through a pilot activity. MCC's investments also work to bolster private-sector participation in the power sector by exploring barriers to finance for independent power producers, and create opportunities for women to participate in the energy sector through both employment and entrepreneurship and

b) Transparent and Accountable Governance Project: Government decision-making is often opaque, leading to distrust by the private sector and civil society, and high perceptions of corruption. Kosovo's judiciary is one of the country's least trusted institutions. This project supports the implementation of a case management information system to make judicial information publicly available, and improvements to the collection and reporting of environmental data to the public. An open innovation competition will let the government pose their challenges to civil society and private sector stakeholders to propose creative, data-grounded solutions, which can be a model for more productive partnerships between government and civil society.

3) MFK intends to use a portion of the grant provided through the Threshold Program to fund Procurement of Implementer for Supply of project management-, air quality information management, behavior change and communication services from a firm/organization ("Consultant").

The Millennium Foundation Kosovo (MFK) is seeking financial and technical proposals to provide project management and technical assistance services for the Supply of project management-, air quality information management, behavior change and communication services from a firm/organization Activity. The objective of this Request for Proposals (RfP) is to select an Implementer (IC) to manage the Activity. The IC shall furnish all required personnel, services, materials, travel, office space and logistics necessary to implement this activity. The IC services will be required including the Pre-Implementation and Implementation Phases. Work is expected to start in May of 2019. The Implementer and its key staff will be based and provide services in Prishtina.

4) This RFP follows the General Procurement Notice that appeared in dgMarket and UNDB Online on 14 September 2018 and local newspapers "Koha Ditore" and "Epoka e re" on 17 September 2018.

5) The Contract duration shall expire on 30 September 2021.

6) This RFP is open to all eligible entities ("Consultants") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the RFP, consultants may associate with other consultants to enhance their capacity to successfully carry out the assignment.

7) A Consultant will be selected under the Quality and Cost Based Selection (QCBS) method, the evaluation procedure for which is described in the RFP, and which is in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website (www.mcc.gov/ppg). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

8) The minimum qualification required of the consulting firm is described in Section III "Qualification and Evaluation Criteria"

9) MFK now invites proposals from legally constituted consulting firms to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference at Section V of this RFP.

10) Consultants wishing to receive the Request for Proposal document in order to submit a proposal must express their interest, indicating their full contact details, by email to: procurement@millenniumkosovo.org.

11) Proposals in electronic submission must be delivered to the link below and in the manner specified in the PDS ITC 17.3 or Annex 1 to section II Proposal Data Sheet procedure for electronic submission of proposals, **no later than 14.00 Kosovo Time (CET time) of 16 April 2019.**

Please submit your proposals using this File Request Link:

Click here to submit proposal (Dropbox file request link)

Office of the Millennium Foundation of Kosovo
Att.: The Procurement Manager
Address: str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana Building, floor IX),
Postal Code:10000 Prishtina, Kosova
Email: procurement@millenniumkosovo.org
Phone Number: 00 383 38 752 110
(Address and Phone number is for information only and is not part of the delivery address.)

E rrallë

Suita më e shtrenjtë e hotelit në botë kushton 88 mijë euro nata

Suita më e shtrenjtë e hotelit në botë kushton 176 500 euro për dy net dhe gjendet në Las Vegas, në brendësi të Palms Casino Resort. Ajo që e bën kaq të kushtueshme këtë suitë prej pothuajse 900 metrash katrorë janë veprat e artit të artistit më të pasur në botë,

ende në jetë, Daniem Hirst (pasuria e tij llogaritet në 215 milionë paundë)

FOTO E DITES

Një burrë me një fytyrë të pikturuar me ngjyra merr pjesë në Panairin e Turizmit ITB në Berlin. /AP/

E jashtëzakonshme

Japonezja 116-vjeçare, më e moshuara në botë

Japonezja Kane Tanaka është 116 vjeçe e 66 ditë dhe është zyrtarisht personi më i vjetër në planet. Jetëgjatësia e saj u konfirmua në një ceremoni të akordimit të rekordit Gines në shtëpinë e saj. E lindur më 2 janar të vitit 1903, ajo është pjesëtare e një familjeje me shtatë

motra dhe vëllezër të tjerë. Nga martesa me bashkëshortin në vitin 1922, Tanaka ka sjellë në jetë katër fëmijë.

BARSOLETA E DITËS

Pacienti: Doktor, pasi kthehem nga puna, kur hyj në shtëpi, me dhemb koka. Mjeku: Zotni, ti ki nevojë për qetësim. Po t'i shkruaj do barna e le t'i përdorë gruaja jote.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Po përpiqeni të jeni më korrektë seç duhet dhe doni të evitoni gabimet. Por, nëse nuk gaboni nuk keni për të mësuar asnjëherë nga gabimet tuaja.

DEMI Koha dhe përkushtimi që duhet t'i dedikoni vetes sot duhet të jetë eksklusiv dhe të mos ngatërrohet me problemet e personave të tjerë.

BINJAKËT Mundësitë që do t'ju ofrohen sot do t'ju japin kënaqësinë të përmirësoni mjaft gjëra tuajat që kishin ngërçe të mëdha dhe donin korrigjime.

GAFORRJA Sot dita juaj do të nisë herët sepse duhet të zgjoheni që në orët e para të mëngjesit. Kjo do t'ju japë shumë energji për të përballuar ditën.

LUANI Nëse jeni të lidhur nga një marrëdhënie pune me persona të caktuar duhet të toleroni edhe sjellje që në jetën e përditshme nuk ju pëlqejnë.

VIRGJERESHA Keni marrë masa dhe keni larguar nga vetja këdo që nuk ju ka pëlqyer. Në një moment të caktuar do të kuptoni që i keni larguar të gjithë.

PESHORJA Sot as nuk duhet të merrni parasysh komentet e personave që i njihni pak dhe kanë një karakter dyshues që nuk përçon asgjë.

AKREPI Nëse doni t'i përngjasoni dikujt që ju e pëlqeni mundohuni të merrni anët me të mira të tij dhe jo ta imitoni duke dalë nga vetja.

SHIGJETARI Keni besuar dhe keni mbështetur persona që tashmë ka ardhur momenti t'ua kthejnë mbrapsht gjithë besimin tuaj. Dita do të jetë e shkëlqyer.

BRICJAPI Keni shumë mundësi për të kaluar mirë ditën sot, por asnjëra prej tyre nuk do t'ju çojë në vendin që do donit të ishit dhe me personin që do të donit.

UJORI Edhe pse keni ndryshuar shumë gjatë kësaj kohë persona të caktuar nuk duan ta pranojnë këtë gjë. Do të vazhdojnë të vënë në dukje difektet tuaja.

PESHQIT Duhet të jeni koherente me të tjerët, por aq me shumë me veten tuaj. Nëse keni bërë një premtim duhet ta mbani pavarësisht rrethanave.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	JUVENTUS - ATLETICO M.	1	MAN CITY - SCHALKE	1-1	DIJON - PSG	2-2

Beqiri: Nuk duam humbje në Drenas

Arben Beqiri për "Epokën e re" ka konfirmuar se Trepça '89 nuk ka fikë nga Feronikeli dhe se në Drenas shkon për të marrë pikë. "Na pret një ndeshje e vështirë ndaj një kundërshtari që po gëzon formë të lartë dhe po lufton për titull, por edhe ne kemi objektivin tonë dhe nuk do të shkojmë të dorëzuar. Synimi ynë është rezultati pozitiv dhe besoj se me një angazhim maksimal mund t'ia arrijmë këtij qëllimi", ka thënë Beqiri

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 MARS - KF Feronikeli është lider në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, kurse në kuadër të javës së 23-të do të takohet me Trepçën '89 në stadiumin "Rexhep Rexhepi". Për t'i arritur pikët e plota skuadrës së "Niklit" dhe për ta vazhduar garën për titull i duhet t'i djersitet shumë, pasi portieri i 89-shit, Arben Beqiri, të hënën ka thënë se synimi i skuadrës nga Mitrovica është të marrë rezultat pozitiv në Drenas. Ai e ka lavdëruar skuadrën lidere, por beson se skuadra e tij mund të dalë e pamposhtur nga kjo ndeshje që pritet të jetë shumë interesante për faktin se vendësit kërkojnë pikët e titullit e mysafirët pikët e mbijetesës. "Na pret një ndeshje e vështirë ndaj një kundërshtari që po gëzon formë të lartë dhe po lufton për titull, por edhe ne kemi objektivin tonë dhe nuk do të shkojmë të dorëzuar. Synimi ynë është rezultati pozitiv dhe besoj se me angazhim maksimal mund t'ia arrijmë këtij qëllimi", ka thënë Beqiri për "Epokën e re".

Portieri Beqiri kohë më parë kishte paralajmëruar se ambiciet e Trepçës '89 janë në garën e Kupës, ku edhe arriti ta befasojë Prishtinën favorite, duke e eliminuar nga kjo garë. Mirëpo kjo skuadër nuk ka treguar stabilitet të madh në ndeshjet kampionale ku me pikët që ka duhet të luajë në ndeshjet e barazhit, por synim i skuadrës nga "Riza Lushta" është mbetja në elitë dhe besimi është i madh që nuk do të ketë nevojë të luajë në barazh. "Nuk besoj se Trepça '89 do të ketë telashe për mbijetesë, duke pasur parasysh seriozitetin e klubit dhe organizimin që e ka ndër vite", ka shtuar Beqiri. Trepça '89 aktualisht është e shtata në elitë me 28 pikë, kurse në gjysmëfinale të Kupës do të takohet me skuadrën e Vëllaznimit më 17 prill në Gjakovë, kurse ndeshjen e kthimit e zhvillon dy javë më vonë në Mitrovicë.

SHKURT

Angli - Kosovë nuk luhet në "Wembley"

Ndeshja kualifikuese në mes të Anglisë dhe Kosovës nuk do të luhet në "Wembley"-n mitik të Londrës. Njoftimin e ka bërë Federata Angleze e Futbollit, duke thënë se vendtakimi i këtyre dy shteteve do të caktohet shumë shpejt. Angli - Bullgari do të luhet në "Wembley", sikurse edhe ndeshja Angli - Çeki, biletat për të cilën ndeshje tashmë pothuajse janë shitur. Përballja në mes të Anglisë dhe Kosovës do të luhet më 10 shtator.

Xhaka në formacionin e javës në Premierë Ligë

Granit Xhaka ka shënuar gola të bukur në fitoren e Arsenalit ndaj Manchester Unitedit (2-0), kurse "Daily Mirror" e ka futur në formacionin e javës. Në këtë formacion bëjnë pjesë: Leno, Maitland-Niles (Arsenal), Mana (Cardiff), Ake (Bournemouth), Zinchenko (City), Xhaka (Arsenal), Mane (Liverpool), Hazard (Chelsea), Ward-Prowse (Southampton), Sterling (Man City), Vardy (Leicester).

Zeneli në formacionin e javës në Francë

Ylli i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, ka vetëm disa javë që është transferuar në kampionatin francez, Ligën 1. Zeneli ka filluar shkëlqimin me Stade Reimsin duke shënuar gola e duke dhuruar asistime. Sulmuesi nga Mitrovica ka shënuar gol këtë javë ndaj Dijonit në barazimin që mori skuadra e tij në udhëtim 1-1. "L'Equipe" e ka përfshirë në formacionin më të mirë të javës.

FShF-ja ndez dritën jeshile për rifillimin e futbollit

Pas tryezës së rrumbullakët që qeveria organizoi me të gjithë presidentët e klubeve, futbolli do të rifillojë sot (e martë) me ndeshjet e Kupës dhe në fundjavë me ndeshjet e kampionatit si normalisht. Të gjitha klubet kanë marrë njoftim nga Federata dhe bojkoti merr fund. Pra, nesër do të kemi dy sfida për "Kupën e Republikës", Partizani do të luajë me Luftëtarin dhe Teuta do ta presë Kukësin. Ndërsa të mërkurën do të luhet Tirana - Laçi. Kamza, meqë është shkualifikuar nga gara, Skënderbeu që ishte kundërshtari i saj për këtë kompeticion, kalon matematikisht në fazën tjetër.

Sylejman Selimi viziton FFK-në

PRISHTINË, 11 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur ish-Komandantin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralin Sylejman Selimi.

Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, shprehu respektin e tij dhe të KE të FFK-së për vlerat dhe kontributin e gjeneralit në luftën çlirimtare, por edhe për kontributin e tij në kohën kur ishte futbollist, duke i dhuruar një pllakate me stadiumin "Fadil Vokrri" si dhe fanellën e përfaqësueses. Ndërkaq gjenerali Sylejman Selimi u shprehu mirënjohje drejtuesve të FFK-së për mikpritjen, njëherësh ngushëllime për ish-presidentin Fadil Vokrri, derisa u shpreh i lumtur për sukseset që po arrin Përfaqësuesja e Kosovës në garat ndërkombëtare si dhe vlerësoi lart vazhdimin e punës së suksesshme nga krerët e FFK-së.

Së shpejti do të krijohet Liga e Veteranëve

Prishtinë, 11 mars - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka pritur të hënën në takim iniciatorët e krijimit të Ligës së Veteranëve: Betim Qerkini, Avni Shala, Enes Shosholli dhe Agim Maliqi. "Kryetari Ademi u njoftua për nismën e tyre dhe hasën në përkrahje të fuqishme të FFK-së. Në këtë takim u arrit pajtueshmëria që sa më shpejt të krijohet Liga e Veteranëve, e cila pa dyshim do të jetë pjesë e rëndësishme e FFK-së. Kryetari Ademi vlerësoi se ideja për krijimin e kësaj lige është shumë e qëlluar dhe është mirë që kjo ligë do të formohet pikërisht nga futbollistët e periudhës së sakrificës dhe e cila si ligë do të jetë shumë atraktive, ngase do t'i mbledhë ish-futbollistët e gjeneratave të ndryshme", thuhet në njoftimin e FFK-së.

CR7 dhe Juve besojnë në kualifikim

Torino, 11 mars - Juventusi e humbi ndeshjen e parë nga Atletico Madridi me rezultat 2-0, por Cristiano Ronaldo beson se "Zonja e Vjetër" ka potencial të mjaftueshëm për ta përmbysur këtë rezultat. Ylli portugez i ka ftuar tifozët të jenë në stadium për të përjetuar një natë speciale, pasi është i bindur në përmbysjen e rezultatit ndaj skuadrës spanjolle. "Bëjeni stadiumin fantastik dhe ne do të bëjmë punën tonë, për të shënuar dhe fituar ndeshjen. Besojmë se do të përjetojmë një mbrëmje të madhe, duke u kualifikuar për në çerekfinale. Atletico është një skuadër e organizuar mjaft mirë, që luan me kujdes mbrapa dhe të pret, për të goditur në kundërsulm. Duhet të bëjmë kujdes dhe ta gjejmë kohën e duhur për t'i goditur, por kam besim se do t'ia dalim të përjetojmë një natë speciale", ka thënë Ronaldo.

Juventusi të premten e fitoi ndeshjen ndaj Udineses (4-1), ani pse trajneri Allegri vendosi ta pushojë shumicën e titullarëve. Fitore ka shënuar edhe Atletico Madridi të shtunën në përballje me Leganesin (1-0). Trajneri Diego Simeone ka thënë se nuk ka frikë nga përmbysja e rezultatit që mund të bëjë Juventusi, por ka paralajmëruar të mos suprizohen nga rezultati final. "Në futboll gjithçka mund të ndodhë. Unë e di forcën e Juves, por di edhe atë të Atleticos, ndaj nuk duhet të surprizoheni nga çdo rezultat që mund të vijë", ka deklaruar Simeone. Në këtë ndeshje skuadra italiane do të jetë pa tre lojtarë mjaft të rëndësishëm si Sami Khedira, Juan Cuadrado dhe Douglas Costa, derisa spanjollët janë pa mesfushorin Thmoas. Kapiteni Diego Godin është në dyshim për këtë ndeshje. Krahas ndeshjes Juve - Atletico, sonte zhvillohet edhe përballja në mes të Manchester Cityt dhe Schalke 04. Skuadra e drejtuar nga Pep Guardiola është afër kualifikimit, pasi e fitoi ndeshjen e parë në Gjermani me përmbysje (3-2).

TË MARTËN TAKOHEN:	
Juventus - Atletico Madrid	(0-2)
Man City - Schalke	(3-2)

Toronto e Milwaukee kualifikohen në çerekfinale

Miami, 11 mars - Skuadra kampione e Golden States u mund 115-111 nga Phoenixin, një humbje e papritur e kryesuesve të Konferencës së Perëndimit. Ndeshje me rivalitet dhe emocione, sidomos në pjesën e dytë, ku herë kryesonte njëri ekip e herë tjetri. Thompsoni realizoi 28 pikë e Duranti 25, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen, ndërsa për miqtë u dallua Bookeri me 37 pikë e 11 asistime. Fiton edhe skuadra e San Antonios, që mundi 121-114 Milwaukeen, ndeshje me dy pamje: Më e mirë për miqtë në të parën, ndërsa në të dytën erdhi përmbysja e Spursit. Aldridge me 29 pikë e 15 rebounde e DeRozani me 28 pikë bënë diferencën në parket për teksanët, duke i bërë të pavlefshme 27 pikë e 13 rebounde të Antetokounmpo. Pavarësisht prej humbjes, skuadra e Milwaukees ruan kreun në renditje në Konferencën e Lindjes dhe siguron që tani kualifikimin në çerekfinalet e "play-off"-it. Bashkë me të edhe Toronto, që mundi sot 125-104 Miamin. Ndeshje e dominuar nga basketbollistët e ekipit kanadez, me 8 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë (Lowry 24 pikë më i miri). Në sekondat e fundit fiton skuadra e Houstonit, që mundi 94-93 Dallasin, ndeshje me rivalitet dhe emocione, me skuadrën e Rocketsit që kishte vazhdimisht epërsinë. Gordoni me 26 pikë ishte shënuesi më i mirë. Detroiti, falë 28 pikëve të Blake Griffinit, mundi 131-108 Chicagon, ndërsa skuadra e Philadelphias fitoi 106-89 ndaj Indianas, sfidë ku u dallua Embiidi me 33 pikë e 12 rebounde.

REZULTATET	
Detroit - Chicago	131-108
Miami - Toronto	104-125
Philadelphia - Indiana	106-89
Atlanta - New Orleans	128-116
Memphis - Orlando	105-97
Dallas - Houston	93-94
Minnesota - New York	103-92
San Antonio - Milwaukee	121-114
Golden State - Phoenix	111-115

SHKURT

Panucci: Nuk kam pasur kontakte me Romën

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Christian Panucci, ka mohuar se kishte rënë në kontakte me Romën për stolin e trajnerit. Në një intervistë për mediet italiane, numri një i stolit të përfaqësueses kuqezi theksoi se mes tij dhe drejtuesve të klubit verdhekuq nuk ka pasur asnjë lloj bisedimi, pasi ai është i përqendruar te puna e tij me Shqipërinë dhe dëshiron ta vazhdojë aventurën me kuqezinjtë. "Nuk më ka telefonuar njeri nga Roma. Kam dëgjuar thjesht zëra në media", ka thënë Panucci. Emri i trajnerit të kombëtares kuqezi u përmend si pasues i Di Francescos te Roma pas shkarkimit të këtij të fundit por, me sa duket, të gjitha këto kanë qenë thjesht aludime.

Serena Williamsi tërhiqet nga Indian Wells

Tenistja amerikane Serena Williams është tërhequr nga turneu Masters i Indian Wells. Probleme shëndetësore për numrin 10 në botë për femra, që është detyruar të tërhiqet sapo ka nisur seti i dytë (ndeshja ishte e vlefshme për raundin e tretë). Williamsi, ish-numri 1 në botë, e nisi mjaft mirë ndeshjen ndaj rivales spanjolle Garbine Muguruza, duke udhëhequr 3-0 me "game". Por papritur ka probleme me tensionin, edhe pse vazhdon të luajë. Muguruza fiton 6 "game" radhazi" dhe fiton 6-3 setin e parë. Tenistja spanjolle fiton edhe "game" e parë të setit të dytë, moment kur ndeshja ndalet. Serena Williamsi kërkon ndihmën e stafit mjekësor, që i masin tensionin. Në këtë moment merret vendimi për t'u tërhequr. Serena e ka fituar dy herë këtë turne, në vitet 1999 dhe 2001, por u tërhoq për më shumë se 15 vjet, pas vërshëllimave për racizëm që mori gjatë ceremonisë. Ajo u rikthye tre vjet më parë, por nuk ka mundur të fitojë më.

Guardiola, besnik i Cityt

Emri i Pep Guardiolës u shtua së fundmi në listën e kandidatëve për ta marrë bankinën e Juventusit në fundin e këtij sezoni, por trajneri spanjoll kërkoi t'i shuajë që në nisje zërat që e largojnë nga Manchester City. Tekniku iberik preferoi edhe publikisht t'i qëndrojë marrëveshjes me kampionët e Anglisë, ndërsa synon të rikonfirmohet në fronin e futbollit ishullor. "Nuk e di pse mediet dhe të tjerët i thonë këto gjëra. E kthyen shpejt në lajm atë që ishte vetëm një postim në 'Twitter'. Unë kam ende dy vjet kontratë këtu dhe do të iki vetëm nëse më shkarkojnë. Nëse ndonjë skuadër më do, duhet ta kuptojë se mbetem te City", ka thënë Guardiola.

Mediet spanjolle: Zidane kthehet te Reali

Sipas disa mediumeve spanjolle, Real Madridi të hënën në mbrëmje do të njoftojë se Zinedine Zidane është kthyer në pozitën e trajnerit në klub. Klubi ka vendosur t'i ndajë rrugët me trajnerin aktual Santiago Solari pas takimit që pati të hënën bordi i drejtorëve. Zidane gjithmonë ka qenë i preferuari i presidentit Florentino Perez, sipas "Marcas". Pas eliminimit nga Kupa e Mbretit dhe Ligës së Kampionëve, por edhe mbetjes prapa në La Ligë, Zidane, sipas raportimit të Jugones, në mbrëmjen e së hënës do të zyrtarizohet te Reali. Francezi u largua nga Reali vetëm nëntë muaj më herët pasi fitoi titullin e tretë rresht të Ligës së Kampionëve.

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë/Ministarstvo za Inovacije i preduzetništvo/ Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

SHPALLJEN E REKRUTIMIT

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Numri i Konkursit:APF0004875
Vendi i punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1- BF/270
Koeficienti : 6
Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar
Periudha provuese: 12 (dymbëdhjetë) muaj
Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i Divizionit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për planifikimin e buxhetit;
- Merr pjesë në hartimin e planeve buxhetore vjetore të institucionit, dhe ndihmon zyrtarët përkatës brenda institucionit për të siguruar që planet kompletohen me përpikëri dhe sipas afat;
- Kujdeset për përcjelljen e gjendjes së buxhetit në free-balanc, monitorimin e shpenzimeve të buxhetit gjatë vitit dhe përgatit raporte lidhur me shpenzimin e buxhetit;
- Evidenton faturat për pagesën e projekteve dhe pagesave në regjistrin përkatës dhe kujdeset për procedimin e tyre me kohë për ekzekutimin e pagesë;
